

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Salih Toplica-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit S. B. nga Podujeva, për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273.par.2.lidhur me nenin 281.par.1.pika 1.9. të KPK dhe kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278.par.1.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.288/2014 të datës 24.06.2015. dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.434/2015 të datës 17.11.2015., në seancën e mbajtur më 23.02.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit S. B. e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.288/2014 të datës 24.06.2015. dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.434/2015 të datës 17.11.2015.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.288/2014 të datës 24.06.2015. i dënuari S. B. është shpallur fajtor për veprat penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe

analoge nga neni 273.par.2.lidhur me nenin 281.par.1.pika 1.9. të KPK dhe kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278.par.1.të KPK dhe pasi për veprën e parë penale i është përcaktuar dënimi me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) € dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh ndërsa për veprën e dytë penale dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, është gjykuar me dënim burgimi unik në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe me dënim me gjobë në shumën e cekur, të cilin është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e në rast të mos pagimit i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur 20 € për një ditë burgimi. Në dënimin me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 20.07.2014. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues i konfiskimit të narkotikut të llojit canabis-marihuanë, në peshë prej 74.924.63 gr si objekt i veprave penale dhe është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës ka marrë aktgjykimin PAKR.nr.434/2015 të datës 17.11.2015. me të cilin aktgjykimin është aprovuar ankesa e Prokurorit Themelor në Prizren dhe aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar përkritazi me vendimin për dënimin “ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarit S. B. për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273.par.1.lidhur me nenin 281.par.1.pika 1.9. të KPK më hollësisht të përshkruar në dispozitivin nën pikën 1 të aktgjykimit, i përcakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite e 6 (gjashtë) muaj ndërsa dënimin me gjobë në shumë prej 3000 € e merr si të vërtetuar, kurse për veprën penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278.par.1.të KPK e merr si të vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe e gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vitesh, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 € e në dënimin me burgim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 20.07.2014. e tutje. Ankesa e mbrojtësit të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar në pjesën tjetër është vërtetuar.”

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati E. R. nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, pa ndonjë propozim.

Prokurori i shtetit me parashtrësën KMLP.II.nr.30/16 të datës 16.02.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale në kërkesë theksohet se për faktet vendimtare aktgjykimi i shkallës së parë fare nuk ka arsye e fakti vendimtar i cili nuk është vërtetuar, ka qenë se i dënuari edhe pse ka qenë në mbajtje të narkotikut i cili është gjetur te ai, nuk ka pas për qëllim shitjen e tij. Lidhur me këtë, pretendohet se mos eliminimi i “qëllimit të shitjes” ka pas për pasojë aplikimin e gabuar të ligjit penal sepse vetëm posedimi i paautorizuar i narkotikut përbënë një vepër tjetër penale nga neni 275. të KPK, për të cilin parashihet dënimi më i butë.

Sa i përket veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278.par.1. të KPK shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale por edhe të ligjit penal, pretendohet se është bërë me faktin se gjykata e ka marrë këtë vepër si vepër të kryer penale edhe pse bima nuk ka qenë në fazën për të dhënë fryte dhe nuk është vërtetuar se a është fjala për bimën femër apo mashkull sepse vetëm bima femër jep fryt. Ligji penal është shkelur edhe me faktin se nuk ka pas bazë që i dënuari të shpallet fajtor për veprën e përfunduar penale por tentativën e veprës penale.

Pasi që këto shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e shkallës së dytë edhe ky aktgjykim, sipas kërkesës, përmban shkelje të njëjta procedurale dhe të ligjit penal.

Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së parë si dhe ajo e shkallës së dytë, kanë dhënë arsye ligjore për që të dy veprat penale.

Nga aktgjykimet e kundërshtuara dhe nga shkresat e lëndës del se i dënuari ka pohuar se paraprakisht me disa persona nga Shqipëria është marrur vesh që të sjellin një sasi të narkotikut, të cilin ai do ta mbanë në shtëpi e më vonë dikush do të vjen për ta marrur dhe pas dorëzimit të narkotikut do tja japin 500 euro si përfitim i tij, se ai në kohën kritike nga këta persona ka pranuar narkotikun dhe e ka vendosur në aneksin e shtëpisë së vëllait, por pas tri orësh ka ardhur policia, ka bastisur lokalitetin dhe narkotikun e ka konfiskuar. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye për gjetjen e saj se i dënuari ka poseduar narkotikun në fjalë me qëllim të shitjes apo shpërndarjes. Ai edhe vet ka deklaruar se të njëjtin, sipas marrëveshjes, ka pas për të dorëzuar personave të caktuar. Edhe në aktgjykimin e shkallës së dytë për këtë fakt janë dhënë arsye të duhura sepse ajo gjykatë në arsyetimin e aktgjykimin të vet ka theksuar se ka qenë fjalë për një sasi të madhe të narkotiku prej 74. kg e 924.63 gr i cili fakt qartazi tregon për ekzistimin e këtij qëllimi. Andaj, nuk mund të aprovohet pretendimi në kërkesë se aktgjykimet nuk përmbajnë arsye ligjore për këtë fakt relevant.

Lidhur me këtë, nuk mund të aprovohet as pretendimi se në dëm të dënuarit është bërë shkelja e ligjit penal kur është fjala për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273.par.2.lidhur me nenin 281.par.1.pika 1.9. të KPK sepse ka ekzistuar qëllimi për shitje apo shpërndarje të narkotikut, siç me vend kanë konstatuar gjykatat në aktgjykimet e kundërshtuara. Nuk mund të bëhet fjalë vetëm për posedim të narkotikut, për çka nuk ka pas vend që vepra penale të cilësohet si vepër penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275. të KPK, siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Nga shkresat e lëndës po ashtu rezulton se i dënuari ka deklaruar se marihunën e ka kultivuar për nevojat e veta, se ka jetuar në Zvicër ku kultivimi i saj nuk ka qenë i ndaluar ashtu që ka menduar se edhe në Kosovë është e lejuar. Mbrojtja e këtillë nuk është aprovuar me arsyetim se për të ekzistuar vepra penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278.par.1.të KPK

mjafton kultivimi i tyre me qëllim të prodhimit të narkotikut, e këtë fakt i dënuari nuk e ka mohuar. Në anën tjetër, në ligj nuk bëhet dallim në mes bimës “femër” apo “mashkull” siç potencohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa faza e zhvillimit të bimës nuk ka pas rëndësi sepse ka ekzistuar qëllimi i të dënuarit për prodhimin e narkotikut. Kjo gjykatë po ashtu konstaton se fjala është për veprën e përfunduar penale e jo për tentativën e saj sepse veprimi i kultivimit në momentin e zbulimit të veprës penale, ka qenë i përfunduar.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 43/2016, më 23.02.2016.

Proçesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka